KËRKESË
Nr. 2990/2, datë 18.6.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Ndërtimi i rrjetit kryesor të kanalizimeve dhe Impiantit të Përpunimit të Ujërave të Përdorura në Plazhin e Velipojës".

Subjekti kërkues i këtij objekti është "Ujësjellës Fshat" sh.a., Shkodër. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e shpronësimit është 4 681 940 (katër milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet) lekë.

Pronarët për të cilët në kolonën "Shënime", në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE
DREJTORIA E PROJEKTEVE IPA

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I IMPIANTIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA PËR ZONËN E VELIPOJËS

Fshati "Paluaj", ZK.3072, Shkodër

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadas.	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sipërfaqja (m^2)	Tokë pemëtore		Vlera totale (lekë)	Shënime
								Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	Emiljan	Nik	Nika	3072	966/7	8,050	8050	262	2109100	2109100	Konfirmim ZRPP
2	Luigj	Dede	Suka	3072	966/5	9,820	9820	262	2572840	2572840	Konfirmim ZRPP
										4681940	

KËRKESË

Shtetasja Irena Gjoni e datëlindjes 18.8.1970, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të vdekur të ish-bashkëshortit të saj, shtetasit Arben Koti, i datëlindjes 3.6.1961.

KËRKUESE
Irena Gjoni